



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1299, datë 11.06.2010

Për

“Disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, dhe .net.al””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e dates 11.06.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën domain-et “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, dhe .net.al””.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronjat k) dhe p) të nenit 8, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115 dhe neni 138 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Rregullore“Për regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën. AL dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar (**Rregullorja**).

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Për administrimin e domain cc.TLD.al dhe nëndomainet e tij, ERT si autoriteti përgjegjës ka nxjerrë Rregulloren përkatëse të miratuar me vendimin nr. 437, datë 21.02.2008 të Këshillit Drejtues. Kjo rregullore është në fuqi edhe pas zëvendësimit të ERT nga AKEP.
2. AKEP, sipas shkronjës k) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 është autoriteti kompetent që administron domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe ENUM.
3. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9918, Rregullorja është zbatuar nga AKEP bazuar në nenin 138 të tij.
4. Me vendim Nr. 1216, datë 07. 04. 2010 “Për miratimin e pagesës për regjistrimin e domain cc. TLD.al” dhe vendimin Nr. 1217, datë 09. 04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën.Al dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, dhe .net.al” të Këshillit Drejtues të AKEP, Rregullorja është amenduar me qëllim reflektimin e disa ndryshimeve të domosdoshme për shkak të përcaktimeve të parashikuara në ligjin e ri nr. 9918 lidhur me emërtesën e autoritetit përgjegjës nga ERT në AKEP, si dhe në kuadër të masave për liberalizimin e mëtejshëm të rregullave për regjistrimin e emrave të domain-eve në zonën “.al”, duke e zgjeruar kategorinë e subjekteve që kanë të drejtë të regjistrojnë emra domain-i në zonën “.al” edhe me personat natyrorë.
5. Me gjithë ndryshimet e pësuara, Rregullorja vijonte të mbarte disa përcaktime megjithëse parimisht të tejkaluara me vendimet e marra nga Këshilli Drejtues, të cituara në pikën 4 të mësipërme, disa përcaktime tashmë të kaluara në kohë si “sunrise period”, si dhe nevojën për ndryshimin e afatit të kryerjes së pagesës për regjistrimin e emrit të domain-it të kërkuar në zonën “.al”, pas njoftimit të AKEP për pranimin e kërkesës së subjektit të interesuar. Ndryshimi i këtij afati ndikon në liberalizimin e mëtejshëm të procedurave, si dhe krijon mundësi të normuara për një efektivitet më të lartë të konkurrencës në këtë drejtim.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë që:

- Projektakti i propozuar përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative;
- Shtesat dhe ndryshimet e propozuara përmirësojnë ndieshëm si anën formale të Rregullores ashtu dhe rregullat në përmbajtje të saj, bazuar në shkronjat k) dhe p) të nenit 8, pikën 1 të nenin 114 dhe pikën të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë miratojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara në rregulloren “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën.Al dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, dhe .net.al”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet sektori i Administrimit të Domain-it .al për zbatimin e këtij vendimi.
3. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit www.akep.al duke kryer njëkohësisht dhe azhornimin e Rregullores me amendimet e pësuara.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN

“Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën *.al* dhe nën domain-et *.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe net.al*”

Neni 1

Në faqen e parë (kapaku) të rregullores bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

(1) Emri i institucionit ndryshon nga ENTI RREGULLATOR I TELEKOMUNIKACIONEVE dhe bëhet:

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE.

(2) Poshtë termit RREGULLORE vendoset përcaktimi NR. __, datë __. 06. 2010 dhe bëhet:

RREGULLORE

Nr.1299, date 11.06.2010

“PËR REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN E EMRAVE TË DOMAINEVE NËN “.al” DHE NËNDOMAIN-ET “.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, dhe .net.al””

Neni 2

Tek pjesa “Të përgjithshme”:

(1) Pika 1, termi “Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT)... ” ndryshon dhe bëhet

“ Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).....”.

(2) Përmbajtja e pikës 5, nga:

“5. Subjekte të së drejtës për të poseduar një ose disa emra domain-esh nën administrimin e Autoritetit Përgjegjës sipas kësaj Rregulloreje në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, janë personat juridikë publikë dhe privatë, si dhe personat fizikë tregtar”,

ndryshon dhe bëhet:

“5. Subjekte të së drejtës për të poseduar një ose disa emra domain-esh nën administrimin e Autoritetit Përgjegjës sipas kësaj Rregulloreje në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, janë personat juridikë publikë dhe privatë, personat fizikë tregtar, **si dhe personat natyrorë”.**

(3) **Pika 6 shfuqizohet.**

Neni 3

Tek neni 1 “Përkufizime”:

(1) Përmbajtja e pikës 1.2, nga:

“1.2 **“aplikuesi”** – është çdo person juridik publik dhe privat, si dhe çdo person fizik tregtar, cili paraqet tek Autoriteti Përgjegjës kërkesën për regjistrimin apo transferimin e një ose më shumë emra domain-esh”,

ndryshon dhe bëhet:

“1.2 **“aplikuesi”** – është çdo person juridik publik dhe privat, çdo person fizik tregtar, **si dhe çdo person natyror**, cili paraqet tek Autoriteti Përgjegjës kërkesën për regjistrimin apo transferimin e një ose më shumë emra domain-esh”.

(2) Përmbajtja e pikës 1.7, nga:

“1.7 **“emërtimi”** – është veprimi që kryhet për përcaktimin e emrave të domain-eve nëpërmjet zbatimit të rregullave të parashikuara në këtë Rregullore. Këto rregulla ndryshojnë sipas institucioneve të autorizuar për të administruar zona të Internetit (.al: ERT, .fr: AFNIC, .uk: Nominet, etj)”,

ndryshon dhe bëhet:

“1.7 **“emërtimi”** – është veprimi që kryhet për përcaktimin e emrave të domain-eve nëpërmjet zbatimit të rregullave të parashikuara në këtë Rregullore. Këto rregulla ndryshojnë sipas institucioneve të autorizuar për të administruar zona të Internetit (.al: **AKEP**, .fr: AFNIC, .uk: Nominet, etj)”

(3) Përmbajtja e pikës 1.19, nga:

“1.19 **“persona fizikë”** – janë personat (natyrorë) që në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë gëzojnë zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar”,

ndryshon dhe bëhet:

“1.19 **“persona natyrorë”** – janë individët që mbushin moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë gëzojnë zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar”.

(4) Pika 1.19/1 shfuqizohet.

Neni 4

Tek neni 3 “Zbatueshmëria”:

(1) Përmbajtja e pikës 3.1, nga:

“3.1 Publikimi i Rregullores në faqen e Internetit <http://www.ert.gov.al> konsideron plotësimin e detyrimit ligjor nga ana e Autoritetit Përgjegjës të publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore”,

Ndryshon dhe bëhet:

“3.1 Publikimi i Rregullores në faqen e Internetit **<http://www.akep.al> konsideron plotësimin nga ana e Autoritetit Përgjegjës të detyrimit ligjor të publikimit të akteve normative administrative të nxjerra prej tij”.**

Neni 5

(1) Neni 5 “Periudha kalimtare (Sunrise period)”, shfuqizohet.

Neni 6

(1) Tek neni 6 “Kategoritë e domain-eve”, si dhe tek të gjitha dispozitat e tjera vijuese të Rregullores, togëfjalëshi i përdorur “përveç *periudhës kalimtare (sunrise period)*”, në çdo rast të përdorur **hiqet** nga përmbajtja e tyre.

Neni 7

Tek neni 7 “Poseduesi i një emri domain-i në zonën “.al”:

(1) Përmbajtja e pikës 7.1, nga:

“7.1 Posedues të një ose disa emra domain-esh në zonën e “.al” dhe nën domain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat, si dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, përveç *periudhës kalimtare (sunrise period)*”,

ndryshon dhe bëhet:

“7.1 Posedues të një ose disa emra domain-esh në zonën “.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat, personat fizik tregtar, si dhe **personat natyrorë**, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

Posedues të një ose disa emra nën domain-esh në zonën “.al” : “.com.al, .org.al dhe .net.al”, kanë të drejtë të jenë personat juridik publikë dhe privat dhe personat fizik tregtar, që sipas procedurës së regjistrimit, plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore”.

Neni 8

Tek neni 10 “Rinovimi i informacionit”:

(1) Përmbajtja e pikës 10.4, nga:

“10.4 Në procedurën e parashikuar në pikën 10.2 nuk përfshihet ndryshimi/korrigjimi i emrit të subjektit (person juridik publik/privat apo fizik tregtar) mbi bazën e të cilit poseduesi ka bërë regjistrimin e emrit të domain-it”,

ndryshon dhe bëhet:

“10.4 Në procedurën e parashikuar në pikën 10.2 nuk përfshihet ndryshimi/korrigjimi i emrit të subjektit (person juridik publik/privat, fizik tregtar **apo person natyror**) mbi bazën e të cilit poseduesi ka bërë regjistrimin e emrit të domain-it”.

Neni 9

Tek neni 12 “Vlefshmëria e emrit të domain-it”:

(1) Përmbajtja e pikës 12.1, nga:

“12.1 Një emër domain-i është i vlefshëm për përdorim nga “poseduesi”, vetëm në periudhën ndërmjet dy pagesave të njëpasnjëshme të kryera prej tij sipas përcaktimeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim”,

ndryshon dhe bëhet:

“12.1 Një emër domain-i është i vlefshëm për përdorim nga “poseduesi”, vetëm në periudhën ndërmjet dy pagesave të njëpasnjëshme të kryera prej tij sipas përcaktimeve të **parashikuara në këtë Rregullore**”.

(2) Përmbajtja e pikës 12.2, nga:

“12.2 Kjo periudhë, përsëritet automatikisht, përveç rasteve kur “poseduesi” paraqet,

sipas kësaj Rregulloreje dhe formës përkatëse, një kërkesë për mbyllje ose kur nuk kryhet pagesa për periudhën në vijim, sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi”,
ndryshon dhe bëhet:

“12.2 Kjo periudhë, përsëritet automatikisht, përveç rasteve kur “poseduesi” paraqet, sipas kësaj Rregulloreje dhe formës përkatëse, një kërkesë për mbyllje ose kur nuk kryhet pagesa për periudhën në vijim”.

Neni 10

Tek neni 19 “Emrat e ndaluar dhe të rezervuar”:

(1) Përmbajtja e pikës 19.3, nga:

“19.3 Autoriteti Përgjegjës në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.ert.gov.al, listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar”,

ndryshon dhe bëhet:

“19.3 Autoriteti Përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Rregullore, përgatit dhe publikon në faqen e Internetit www.akep.al, listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar”.

Neni 11

Tek neni 23 “Faturimi i pagesave për regjistrimin dhe posedimin e emrave të domain-eve”:

(1) Përmbajtja e pikës 23.1, nga:

“23.1 E drejta për posedimin e një emri domain-i, pas miratimit nga Autoriteti Përgjegjës, bëhet efektive me kryerjen e pageses përkatëse, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, nga ana e përfituesit (poseduesit)”,

ndryshon dhe bëhet:

“23.1 E drejta për posedimin e një emri domain-i, pas miratimit nga Autoriteti Përgjegjës, bëhet efektive me kryerjen e pageses përkatëse nga ana e përfituesit (poseduesit), **sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje**”.

(2) Përmbajtja e pikës 23.2, nga:

“23.2 Pagesa e parashikuar për posedimin e një emri domain-i përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave”,

ndryshon dhe bëhet:

“23.2 Pagesa e parashikuar për posedimin e një emri domain-i përcaktohet me **Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it**”.

(3) Përmbajtja e pikës 23.4, nga:

“23.4 Pagesa duhet të bëhet brenda 20 ditëve kalenderike nga data e miratimit të aplikimit, përndryshe aplikimi shpallet i pavlefshëm dhe aplikanti duhet të riaplikojë nga fillimi”,

ndryshon dhe bëhet:

“23.4 Pagesa duhet të bëhet brenda **2(dy)** ditëve pune nga data e miratimit të aplikimit, përndryshe aplikimi shpallet i pavlefshëm dhe aplikanti duhet të riaplikojë nga fillimi”.

Neni 12

Tek neni 25:

(1) Përmbajtja e pikës 25.2, nga:

“25.2 Në rast mospagese të detyrimeve të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave dhe këtë Rregullore, Autoriteti Përgjegjës bën bllokimin e emrit të domain-it për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike. Gjatë kësaj periudhe, poseduesi ruan të drejtën e rihapjes së emrit ekzistues duke kryer pagesën përkatëse”,

ndryshon dhe bëhet:

“25.2 Në rast mospagese të detyrimeve të parashikuara në Vendimin përkatës të **Këshillit Drejtues të AKEP** dhe këtë Rregullore, Autoriteti Përgjegjës bën bllokimin e emrit të domain-it për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë kalendarike. Gjatë kësaj periudhe, poseduesi ruan të drejtën e rihapjes së emrit ekzistues duke kryer pagesën përkatëse”.

Neni 13

Tek neni 32 “Konfidencialiteti dhe ruajtja e privacisë”:

(1) Përmbajtja e pikës 32.1, nga:

“32.1 Informacioni dhe dokumentat e mbajtura nga/ose të depozituara tek Autoriteti Përgjegjës, konsiderohen nga natyra e tyre si konfidenciale dhe nuk do të kalohen tek të tretët vetëm nëqoftëse kërkohet nga ligji apo në lidhje me një procedurë alternative për zgjidhje mosmarrëveshje ose konflikti”,

Ndryshon dhe bëhet:

“32.1 Informacioni dhe dokumentat e mbajtura nga/ose të depozituara tek Autoriteti Përgjegjës, konsiderohen nga natyra e tyre si konfidenciale dhe nuk do të kalohen tek të tretët, **përveçse kur kjo përbën:**

a) **një detyrim ligjor;**

b) **kur me kërkesë me shkrim të depozituar në Autoritetin Përgjegjës, një palë e interesuar kërkon të dhënat e domosdoshme për një ose disa “posedues” me qëllim ngritjen e padisë kundra tij/tyre, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 154), për fillimin e një procedure alternative për zgjidhje mosmarrëveshje ose konflikti”.**

Neni 14

Tek neni 37 “Ligjshmëria”:

(1) Përmbajtja e pikës 37.1, nga:

“37.1 Kjo Rregullore administrohet sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe në kuptimin administrativ specifikisht nga ligji nr.8618, datë 14.6.2000, “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodi i Procedurave Administrative”,

ndryshon dhe bëhet:

“37.1 Kjo Rregullore administrohet sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 15

(1) Aneksi 1 “Dispozitat mbi të cilat do të bëhet regjistrimi i emrave të domain-eve gjatë periudhës kalimtare (sunrise period), **shfuqizohet.**